

A dëshiron të keshë një punë me variacione dhe përgjegjësi të madhe?  
A dëshiron të punosh me çështje që janë të flakta dhe aktuale?  
A dëshiron të keshë mundësi që të nisësh sipërmarrjen tënde në ardhmëri?  
A dëshiron të kërkoesh punë menjëherë pas gjimnazit?  
A dëshiron të keshë mundësi të punosh dhe të studjosh jashtë vendit?  
Në atë rast Programi i energjisë mund të jetë për ty.

Te Programi i energjisë të jepet mundësia që të mësosh bazat me qëllim që të punosh me sisteme teknike në fushat e energjisë, ndërtesave, nxemjes, ventilimit dhe sanitetit (VVS), teknika e ftohjes dhe të detarisë. Siç e ke kuptuar tashmë, kjo është një lëmi shumë e gjërë dhe do të keshë mundësi të gjajsh pikërisht atë drejtim që të përshtatet ty. Në rast se shikon televizor ose e lexon një gazetë do të zbulosh se një pjesë e madhe e lajmeve dhe debateve kanë të bëjnë me energji. Aspektet ambientale dhe menidimi i cikleve është me rëndësi për kulifikimin. Ty dhe shokëve të klasës do të ju jepet mundësia që të mendoni me nyra të ndryshme se si mund të na ndihmojë teknika që të krijojmë një shoqëri të qëndrueshme.

Pjesa më e madhe e asaj që do të mësoni te Programi i energjisë mund të përdoret te viset e tjera të botës. Në rast se ke dituri gjuhësore dhe gjithashtu interesim dhe kuptim për shtete tjera, mund pikërisht për këtë arsye të punosh ku të duash.

## Të punosh apo t'i vazhdosh studimet

Nëse zgjedh Programin e energjisë mund të kërkoesh punë menjëherë pas gjimnazit. Llojet e punëve ku mund të pranohesh varren nga drejtimi që e ke zgjedhur. Në disa raste të jepet mundësia që të fillimisht të punosh si çirak gjatë një viti apo gjatë disa viteve. Në atë rast të marrësh rrogë çiraku dhe do të jepet mundësia të punosh së bashku me persona që janë të punësuar në lëminë tënde që të mësosh prej tyre. Ato kanë dituri të posaçme dhe kanë përvojë pune të gjatë.

Nëse dëshiron, mundesh edhe t'i vazhdosh studimet pas gjimnazit. Mund të zgjedhësh një kulifikim tek Fakulteti i profesioneve që të jep ato dituri që të interesojnë. Mund të vazhdosh studimet në universitet apo fakultet. Nëse zgjedh të mësosh teknik detare në gjimnaz, të jepet mundësia që më vonë të vazhdosh studimet në fakultetin e kapitenëve detarë.

## Punë ku mund të pranohesh

Pasi që e përfundon Programin e energjisë mundesh për shembull të kërkoesh punë si makinist i prodhimit, reparues, operator, teknik, kujdestar, qiradhënës banesash, qiradhënës shtëpishë dhe operator.

Në rast se zgjedh të vazhdosh studimet pas gjimnazit, ke mundësi të mira që të kërkoesh shumë lloje punësh. Në rast se që tani e di se me çka dëshiron të punosh, duhet të flësh me udhërrëfyesin e studimeve dhe të profesioneve. Ajo apo ai mund të të ndihmojnë që të zgjedhësh kursin dhe drejtimin e duhur.

## **Përmbajtja e Programit**

Programi i energjisë përbëhet prej kurseve. Disa kurse janë obligatorike për të gjithë ata që studiojnë në gjimnaz. Kurse e tjera janë veçanta për Programmin e energjisë. Disa nga kurset do të mund t'i zgjedhësh vetë.

Programi përbëhet prej tre drejtimeve ndërkombëtare. Kjo do të thotë se të gjithë ata që studiojnë në Programin elektrik në tërë vendin mund t'i zgjedhin drejtimit. Në disa vende mund të ketë edhe me tepër drejtime që ndoshta të përshtaten ty më së miri. Pyete udhërrëfyesin tënd të studimeve dhe të profesioneve.

Drejtimet kombëtare janë:

- Teknika për mirëmbajtje dhe prodhim – për ty që do të punosh me mirëmbajtje të ndërtesave, centrale energjike dhe të nxemjes, në industrinë procesiale ose me teknika ujore dhe ambientale (një drejtim që është vetëm në Oskarshamn, por që të gjithë kanë të drejtë të kërkojnë)
- Teknikë detare – për ty që dëshiron të punosh në detari, ose në kuvertë ose në dhomën e maqinerisë
- Vvs – dhe teknikë të ftohjes – për ty që dëshiron të punosh me instalime, shërbim dhe prodhime poashtu dhe mirëmbajtje të sistemeve teknike.

## **Kontakte me tregun e punës**

Te Programi elektrik do të kesh kontakte me tregun e punës që nga koha e gjimnazit. Do të keshë të paktën 15 javë kualifikim në vende të punës (APU). APU-në tënde e planifikon shkolla në bashkëpunim me vende të lira të punës aty ku banon ti. Është një mënyrë e mirë që të krijoni kontakte të cilat mund t'i përodrësh kur do të kërkoresh punë. Në rast se kompanitë në vendin tënd kanë nevojë për personel me kualifikim energjetik që janë të specializuar në një lëmi të veçantë, atëherë shkolla përshtate zakonisht sipas kërkesave. Nëse të intereson ta bësh APU-në tënd në një vend tjetër përveç Suedisë, kjo mundësi do t'ju jepet.

Nëse do të zgjedhësh teknikën detare si drejtim duhet të mendosh se do të duhet një vërtetim mjekësor kur do ta bëni APU-në. Nëse do të punosh dhe ke ndërmend të bësh APU te reparti i kuvertës do të duhet p.sh. të kesh një pamje komplete të ngjyrave dhe një shiqim me të paktën 0,8 pa syze kur shiqon me të dyja sytë njëkohësisht. Nëse dëshiron të jesh në dijeni më tepër në lidhje me këto kërkesa, mund të flaësh me udhërrëfyesin tënd të studimit dhe të profesionit.

## **Ardhmëri dhe punë**

Do të ketë edhe me tepër nevojë për të kualifikuar për energji. Ne njerëzit kemi nevojë për burime të reja të energjisë, dhe burimet e vjetra të energjisë duhet të efektivizohen. Nëse do të jetë e lehtë për ty që të punësoshesh pasi që e përfundon Programin e energjisë, kjo mund të varret nga drejtimi që e zgjedh dhe se në rast se mund të paramendosh që të vazhdosh studimet. Nëse për shembull ke dëshirë që të bëhesh montues i vvs, ke mundësi të mira për

punësim menjëherë pas gjimnazit. Por në rast se dëshiron të bëhesh teknik ose inxhinier, është më lehtë të punësohesh në rast se i vazhdon studimet.